



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE

Nr. 607/4 prot.

Datë 01.04. 2024

RAPORT

**“PËR
KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: “MBI PRAKTIKËN DHE
SHKAQET E ZËVENDËSIMIT TË PROKURORËVE PËR PERIUDHËN 01.01.2022-
31.12.2022”, TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në zbatim të vendimit nr. 6/5, datë 30.06.2023, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022” të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, PRILL 2024

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik me objekt "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022", në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.

Data e përgatitjes:

01.04.2024

Përgatitur nga:

Znj. Alma Tafani
Znj. Lindita Ziguri
Z. Julian Zonja

Për shqyrtim nga:


Inspektori i Lartë i Drejtësisë
Z. Artur Metani



Miratoi Ndryshoi Ktheu

Datë 01.04.2024

10 10



10 10

I. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenet 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat “dh”, “ë” dhe “k” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 6 , datë 24.02.2023 “Planin e inspektimeve për vitin 2023”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 6 , datë 24.02.2023 “Planin e inspektimeve për vitin 2023”, i ndryshuar, është planifikuar zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 6/5, datë 30.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u angazhuan inspektorët, znj. Alma Tafani, znj. Lindita Ziguri dhe z. Julian Zonja. Gjithashtu, me qëllim rritjen e efencës së grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektore znj. Alma Tafani.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi konsiston në Kushtetutën e Republikë së Shqipërisë, neni 147/d, pika 2 i cili parashikon se: “2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”, në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 204, pika 1, germa “dh”, i cili parashikon se: “Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme “dh”: “... miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale e tematike”; në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 6, i cili parashikon se: “6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve”.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorëve lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu janë administruar edhe:

- Raporti vjetor për vitin 2022 i Prokurorisë së Përgjithshme;
- Rregullorja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë, miratuar nga Drejtuesit e Prokurorive.

Me vendimin nr. 598/10, datë 30.06.2023 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022” Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur:

1. “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”.

2. Inspektimi tematik do të zhvillohet në:

- a) Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- b) Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- c) Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- ç) Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

3. Inspektimi tematik do të zhvillohet gjatë periudhës kohore 01.07.2023-29.12.2023, si dhe do të realizohet sipas këtyre fazave:

- a) përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, brenda datës 10.07.2023;
- b) përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur, e cila duhet të përfundojë brenda datës 10.11.2023;
- c) hartimi i raportit përfundimtar, brenda datës 29.12.2023;
- ç) ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit brenda 6 muajve nga data e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit.

4. Inspektimi tematik të kryhet nëpërmjet administrimit pranë prokurorive të përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, të të dhënave, informacionit apo dokumentacionit shkresor të mëposhtëm:

- a) dokumentacioni lidhur me çdo praktikë për zëvendësimin e prokurorit, përfshirë kërkesat e palëve dhe vendimi përkatës i drejtuesit në lidhje me këto kërkesa;
- b) dokumentacioni lidhur me çdo praktikë për vendimet e marra kryesisht nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit;
- c) informacionin dhe dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për procedurën e shortit të ndjekur për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit tjetër; si edhe
- ç) çdo informacion/dokumentacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm gjatë veprimtarisë së

inspektimit, në përputhje me nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

5. Për kryerjen e këtij inspektimi, ngarkohen inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:
 - a) Znj. Alma Tafani, asistuar nga znj. Aulona Levani, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe asistuar nga z. Julis Zebi, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
 - b) Z. Julian Zonja asistuar nga z. Arbër Myftari dhe z. Renato Tushaj, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 - c) Znj. Lindita Ziguri asistuar nga znj. Loreta Jashari dhe znj. Alma Troshani, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, caktohet si kryetar grupi znj. Alma Tafani, që është përgjegjëse për:
 - a) bashkërendimin e punës për hartimin e planit dhe përcaktimin e afateve konkrete;
 - b) vendosjen e kontakteve të para me drejtuesit e zyrave të prokurorive, si edhe pikat e kontaktit;
 - c) kërkimin e informacionit nga zyrat e prokurorive objekt i inspektimit;
 - ç) zhvillimin e takimeve periodike për ndjekjen e ecurisë së punës së të gjitha grupeve të inspektimit;
 - d) marrjen e masave për administrimin e korrespondencës shkresore sipas ndarjes së prokurorive në një data bazë elektronike, e cila është e aksesueshme nga të gjitha grupet e inspektimit;
 - dh) marrjen e masave për unifikimin e praktikës së punës nga të gjitha grupet në veçanti duke përcaktuar strukturën e projekt raportit të inspektimit;
 - e) koordinimin e punës për hartimin e raportit përfundimtar të inspektimit mbi bazën e gjetjeve nga secili grup;
 - f) komunikimin e çdo problematike të hasur nga grupi ose çdo nevojë për qëllime të përmbushjes së inspektimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;
 - g) informimin periodikisht ose me kërkesë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për ecurinë e inspektimit;
 - gj) paraqitjen e draft raportit përfundimtar të inspektimit me gjetjet përkatëse për miratim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i propozuar sipas rastit edhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ecurisë së inspektimit tematik;
 - h) çdo detyrë tjetër në kuadër të procesit të inspektimit.
7. Kryetari i grupit, në bashkëpunim me inspektorët përgjegjës, harton dhe dorëzon pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin për vijimin e punës, brenda datës 10.07.2023.
8. Kryetari i grupit të inspektimit raporton në përfundim të çdo faze inspektimi, të përcaktuar



në pikën 3, të këtij vendimi, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në çdo rast që kërkohet prej tij.

9. Projektvendimi dhe raporti i inspektimit hartohet nga inspektorët dhe i dërgohet për shqyrtim brenda datës 29.12.2023 Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas përcaktimeve të nenit 214, pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

- Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e prokurorive subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.01.2022 deri 30.12.2022.

Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:

- (i) Dokumentacionin lidhur me çdo deklaram për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, përfshirë kërkesat e palëve.
- (ii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për vendimet e marra nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit.
- (iii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për procedurën për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit tjetër.

Qëllimi i këtij inspektimi tematik ishte vlerësimi i praktikave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër, lidhur me zbatimin e kriterëve ligjore mbi kërkesat apo deklaramet me objekt: “Heqje dorë” nga prokurori gjatë hetimit të procedimit penal, si dhe veprimtarisë së drejtuesve të prokurorive në lidhje me vendimet për “Pranimin ose jo të deklaramit për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit”, vendimet për zëvendësimin e prokurorit, hedhjen e shortit dhe njoftimin e palëve.

Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar qartë detyrimet e magjistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale, kështu në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Në këtë inspektim u vlerësua fillimisht veprimtaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër. Këto dy prokurori kanë ndjekur një praktikë të caktuar, duke filluar nga regjistrimi i “kërkesës” së prokurorit për heqje dorë regjistruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale. Kjo kërkesë i është përcjellë Drejtuesit të Prokurorisë, i cili ka dalë me vendim për pranimin e

kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, regjistrimin e këtij vendimi në protokoll, hedhjen e shortit dhe njoftimin e prokurorëve me këtë vendim.

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë objektit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektimi tematik paraqet rëndësi në krijimin e një panorame të përgjithshme në lidhje me praktikën e ndjekur dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorit.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër, mundësoi njohjen me praktikën në lidhje me deklaratimet e prokurorëve për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, vendimet e drejtuesit të prokurorisë për pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit, si dhe procedurën e ndjekur për caktimin e prokurorit tjetër me short, depozitimin/protokollimin e këtyre akteve në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale dhe njoftimin e prokurorëve. (Praktikë e ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër).

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 rezultoi se:

A.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 janë depozituar në sekretari 22 (njëzet e dy) kërkesa me objekt: “*Deklarim për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, të paraqitura me shkrim nga prokurorët, të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj prokurorie.

Drejtuesi i Prokurorisë në lidhje me 22 (njëzet e dy) kërkesat e paraqitura nga prokurorët me objekt: “*Deklarim për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, ka disponuar me 22 vendime për pranimin e kërkesës së prokurorit.

Në këtë prokurori evidentohet fakti i zbatimit të praktikës me përcjelljen e kërkesës së prokurorit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, në përputhje të nenit 42, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 43, pika “d”¹, nenit 45, pika 2², nenit 49³ të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, është zbatuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe*

¹d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj.

² 2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

³ Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe Udhëzimi i Përgjithshëm i drejtuesit të prokurorisë nr. 39PBD, datë 07.09.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Kërkesat e paraqitura për heqjen dorë të prokurorit janë të regjistruara në sekretari, në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, ku secila kërkesë ka nr. e protokollit përkatës, në kolonën “*Dhënia e informacionit nga prokurori*” dhe datën e kalimit nga prokurori tek Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kërkesë e cila regjistrohet në librin e protokollit të komunikimeve të brendshme (LPKB)⁴. Drejtuesi pas marrjes së kërkesës ka proceduar me marrjen e vendimit për “Pranimin ose jo të deklarimit të heqjes dorë dhe për zëvendësimin e prokurorit...”. Ky vendim është regjistruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, në rubrikën “*Kalimi i akteve të firmosura tek prokurori*”.

Në praktikën e administruar mbi zëvendësimin e prokurorit në këtë prokurori konstatohet se menjëherë pas vendimit të drejtuesit është kaluar tek hedhja në short sipas seksionit përkatës.⁵

Nga analiza e vendimeve të marra nga Drejtuesi i Prokurorisë, konstatohet se në të 22 rastet kanë qenë prokurorët ata që kanë paraqitur “*kërkesë për heqje dorë*” nga hetimi i procedimeve penale. Drejtuesi i ka pranuar të 22 kërkesat dhe në këto vendime është analizuar baza ligjore dhe arsyet për pranimin e kërkesës së prokurorit.

Për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022, lidhur me vendimet mbi zëvendësimin e prokurorit nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nuk është evidentuar asnjë rast që vendimi për zëvendësimin e prokurorit të jetë vendosur “*kryesisht*” nga drejtuesi.

B.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 janë depozituar në sekretari 32 (tridhjetë e dy) kërkesa me shkrim me objekt: “*Deklarimin për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, të paraqitura me shkrim nga prokurorët, të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj prokurorie.

Drejtuesi i Prokurorisë në lidhje me të 32 (tridhjetë e dy) kërkesat e paraqitura nga prokurorët me objekt: “*Deklarimin për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, ka disponuar me 32 vendime për pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit.

⁴ Pika 13, Udhëzimi nr. 39PBD, datë 07.09.2020⁴ të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

⁵ Shiko procesverbalet e hedhjes në short, të administruara me shkresën nr. 6927/1 prot., datë 20.07.2023.

Në këtë prokurori evidentohet fakti i zbatimit të praktikës për përcjelljen e kërkesës së prokurorit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, në përputhje të nenit 42, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 43, pika “d”⁶, nenit 45, pika 2⁷, nenit 49⁸ të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, është zbatuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe Udhëzimi i Përgjithshëm i drejtuesit të prokurorisë nr. 33, datë 04.09.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë”.

Në zbatim të udhëzimeve të mësipërme, Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 2, datë 07.01.2021 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”.

Në lidhje me kërkesat mbi “Deklarimin për heqje dorë”, të paraqitura me shkrim nga prokurorët, në këtë prokurori është evidentuar fakti se këto kërkesa janë të regjistruara në sekretari dhe pasi protokollohen në “Regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë”, përcillen me protokoll tek Zyra e Drejtuesit të Prokurorisë, ku secila kërkesë ka nr. e protokollit përkatës dhe datën e kalimit tek drejtuesi i prokurorisë.

Në praktikën e administruar mbi zëvendësimin e prokurorit në këtë prokurori konstatohet se menjëherë pas vendimit të drejtuesit është kaluar tek hedhja në short sipas seksionit përkatës.⁹

Nga analiza e vendimeve të marra nga Drejtuesi i Prokurorisë, konstatohet se në të 32 rastet kanë qenë prokurorët ata që kanë paraqitur “kërkesë për heqje dorë” nga hetimi i procedimeve penale. Drejtuesi i ka pranuar të 32 kërkesat dhe në këto vendime është analizuar baza ligjore dhe arsyet për pranimin e kërkesës së prokurorit.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, lidhur me vendimet mbi zëvendësimin e prokurorit nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, nuk është evidentuar asnjë rast që vendimi për zëvendësimin e prokurorit të jetë vendosur “kryesisht” nga drejtuesi.

⁶d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj.

⁷ 2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

⁸ Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

⁹ Shiko procesverbalet e hedhjes në short.

C.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 janë paraqitur 22 (njëzet e dy) kërkesa për "Heqjen dorë" nga hetimi i procedimit penal, të paraqitura nga prokurorët e kësaj prokurorie për shkaqe të ndryshme, të cilat rezultojnë të paprotokolluara dhe të paregjistruara në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale.

Drejtuesi i prokurorisë në lidhje me të 22 (njëzet e dy) kërkesat e paraqitura nga prokurorët me objekt: "Deklarimin për heqje dorë" nga hetimi i procedimit penal, ka disponuar me 22 (njëzet e dy) vendime për pranimin e kërkesës së prokurorit.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë **nuk evidentohet** fakti i zbatimit të praktikës për përcjelljen e kërkesës së prokurorit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, në përputhje me nenin 42, shkronjat "a" dhe "c", nenin 43, pika d, nenin 45, pika 2 dhe nenin 49 të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesat nuk rezultojnë të regjistruara në sekretari, të protokolluara në "Regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë", sipas Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" dhe secila kërkesë nuk ka, nr. e protokollit përkatës dhe datën e kalimit tek drejtuesi i prokurorisë, siç është zbatuar në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër.

Në zbatim të udhëzimit të mësipërm të Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka nxjerrë aktet e mëposhtme në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 04, datë 04.09.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm".

Nga aktet e administruara rezulton se kërkesat e paraqitura me shkrim nga prokurorët mbi "Deklarimin për heqje dorë", si dhe vendimet e drejtuesit mbajnë vetëm datën e kërkesës së prokurorit dhe vendimit të drejtuesit. Këto akte nuk rezultojnë të jenë të protokolluara në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale. Si rrjedhim nuk evidentohet data e kalimit nga prokurori tek drejtuesi dhe anasjelltas.

Nga analiza e vendimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë, konstatohet se në të 22 rastet kanë qenë prokurorët ata që kanë paraqitur "kërkesë për heqje dorë" nga hetimi i procedimeve penale. Drejtuesi i ka pranuar të 22 kërkesat dhe në këto vendime është analizuar baza ligjore dhe shkaqet për pranimin e kërkesës së prokurorit.

Në praktikën e administruar mbi zëvendësimin e prokurorit në këtë prokurori konstatohet se pas vendimit të drejtuesit është kaluar tek hedhja në short sipas seksionit përkatës.¹⁰

Për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022, lidhur me vendimet mbi zëvendësimin e prokurorit nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nuk është evidentuar asnjë rast që vendimi për zëvendësimin e prokurorit të jetë vendosur “kryesisht” nga drejtuesi.

D.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 nuk identifikohet se sa kërkesa janë depozituar në sekretari me objekt: “*Deklarimin për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, të paraqitur me shkrim nga prokurorët ose subjekte të tjera të procedimit penal.

Gjithashtu nuk evidentohet fakti i zbatimit të ndonjë praktike për përcjelljen e kërkesës së prokurorit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, në përputhje me nenin 42, shkronjat “a” dhe “c”, nenin 49¹¹ të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesat nuk rezultojnë të regjistruara në sekretari, të protokolluara në “*Regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me drejtuesin e prokurorisë*”, sipas Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*”. Në zbatim të udhëzimit të mësipërm të Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka nxjerrë Udhëzimin nr. 26, datë 30.07.2020, “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*”.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 është identifikuar praktika e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit që lidhet kryesisht me faktin që një pjesë e prokurorëve janë shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pas vendimit të shkarkimit rezulton se janë nxjerrë urdhra nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për hedhjen në rishortim elektronik të çështjeve në hetim, gjykim dhe të materialeve kallëzuese.

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë informohemi për 480 raste të zëvendësimit të prokurorit për shkak se prokurori i

¹⁰ Shiko procesverbalet e hedhjes në short.

¹¹ Zëvendësimi i prokurorit.

mëparshëm është shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe 3 (tre) raste të zëvendësimit të prokurorit për shkaqe shëndetësore. Këto 3 raste përfshihen në shkaqet e zëvendësimit të prokurorit, pasi kemi të bëjmë me shkak ligjor të parashikuar nga neni 49, pika 2 i ligjit nr. 97/2016, ku thuhet: *“Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore”*.

Për të gjitha këto raste janë përcjellë urdhrat përkatës të drejtuesit të prokurorisë për hedhjen në short të çështjeve të prokurorit të shkarkuar me qëllim rishpërndarjen e dosjeve. Janë përcjellë 10 (dhjetë) urdhra për hedhjen në short të çështjeve ku është zëvendësuar prokurori, nga të cilat 7 (shtatë) urdhra që kanë të bëjnë me prokurorë të shkarkuar me vendim të KPK-së ose KPA-së dhe 3 (tre) urdhra që kanë të bëjnë me prokurorë të larguar përkohësisht për shkaqe shëndetësore, ku 2 (dy) urdhra lidhen me të njëjtin prokuror.

Të gjitha rastet e zëvendësimit të prokurorëve për shkak të pezullimit ose të humbjes së statusit për shkak të shkarkimit nga organet e rivlerësimit kalimtar, nuk përfshihen në objektin e inspektimit për zëvendësimin e prokurorit sipas parashikimeve ligjore (me kërkesë të palëve, me deklaram për heqje dorë të prokurorit për çështjen konkrete, apo me vendim zëvendësimi të marrë nga drejtuesi i prokurorisë) dhe si i tillë ky informacion do të përdoret vetëm për efekt statistikor.

Nga aktet e administruara rezulton se nga kjo prokurori nuk na janë përcjellë deklaramet e prokurorëve mbi heqjen dorë, si dhe vendimet e drejtuesit në lidhje me këto deklaramet. Si rrjedhim është e pamundur të evidentohen rastet e deklarametve të heqjes dorë/ose kërkesave të palës për heqje dorë të prokurorit dhe rastet e vendimeve të drejtuesit të prokurorisë për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, arsytet e pranimit ose jo të këtyre kërkesave, si dhe praktika e ndjekur mbi këto raste.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akteve drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna ku është mundur marrja e informacionit dhe dokumentacionit shkresor gjatë periudhës objekt inspektimi 01.01.2022–31.12.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹²; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër¹³; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

¹² Shkresë nr. 6927/1 prot., datë 20.07.2023. Regjistruar në ILD me nr. 2198/5 prot., datë 21.07.2023.

¹³ Shkresa nr. 6205/1 prot., datë 28.07.2023. Regjistruar në ILD me nr. 2198/7 prot., datë 02.08.2023.

Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë¹⁴; si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹⁵.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e prokurorive është përqendruar në drejtim të (i) kërkesës së palëve për zëvendësim të prokurorit dhe deklarimit të prokurorit për “Heqjen dorë”, (ii) datës së regjistrimit të kësaj kërkesë dhe kalimin të drejtuesi i prokurorisë, (iii) vendimin e drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit, hedhjen e shortit për caktimin e prokurorit zëvendësues dhe njoftimin e palëve.

Trajtimi i këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 42, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 43, pika “d”¹⁶, nenit 45, pika 2¹⁷, nenit 49¹⁸ të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Me qëllimin që analizimi i të dhënave të mbledhura të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, nga grupi i inspektimit u morën edhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend, konkretisht raportet vjetore të Këshillit të Lartë Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.

Në raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022, miratuar me vendimin nr. 89, datë 24.04.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në faqen 8 të këtij raporti është paraqitur në formë tabelore organika e prokurorive objekt inspektimi si më poshtë:

Prokuroritë	Organika	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Vakancë total	Në detyrë
Elbasan	25	5	5	11	14
Tiranë	80	26	13	39	41
Vlorë	19	6	0	6	13
Shkodër	19	5	3	8	11

Në vijim është pasqyruar analiza ligjore me të dhënat përkatëse që janë përpunuar mbi secilin

¹⁴ Shkresa nr. 2198/4 prot., datë 20.07.2023 Regjistruar në ILD me nr. 2198/6 prot., datë 31.07.2023.

¹⁵ Shkresa nr. 1854/4 prot., datë 15.05.2023 Regjistruar në ILD me nr. 2198/4 prot., datë 20.07.2023.

¹⁶d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj.

¹⁷ 2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

¹⁸ Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

subjekt të inspektimit, pas trajtimit të informacioneve të dërguara nga prokuroritë, raportet vjetore të punës të secilës prokurori, informacionit të trajtuar në raportet vjetore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për këto prokurori. Pjesë e analizës ligjore për secilën prokurori është situata aktuale që rezulton nga gjetjet e inspektimit si, praktika në lidhje me kërkesën e palëve për zëvendësimin e prokurorit dhe deklarimin e prokurorit për heqjen dorë dhe deri te vendimi i marrë nga drejtuesi dhe procedura për zëvendësimin e prokurorit. Gjithashtu është vlerësuar edhe gjendja reale e burimeve njerëzore duke pasur parasysh ngarkesën e prokurorive, si dhe rastet e zëvendësimeve të prokurorëve për shkak të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, ku një pjesë e madhe e magjistratëve prokurorë janë larguar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK)/KPA. Pjesa më e madhe e prokurorëve të shkarkuar nga vetingu evidentohen se janë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nga ky raport rezulton se nuk ka asnjë rast të vendimit të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit dhe si rrjedhim edhe të ankimeve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

A. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik¹⁹ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan** vendosi në dispozicion kopje të njësuara të praktikave të zëvendësimit të prokurorit, të cilat përfshijnë: kërkesë të prokurorit për heqje dorë, vendim për shqyrtimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit, procesverbal shorti, si dhe një kopje të “Regjistrin të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale”.

Gjithashtu u vendosën në dispozicion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Udhëzimi nr. 39PBD, datë 07.09.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe Urdhri nr. 85, datë 29.07.2022, i drejtuesit të prokurorisë “Për organizimin dhe funksionimin e punës, delegimin e kompetencave, si dhe dhënien e lejeve të zakonshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë pushimeve vjetore nga data 01 gusht 2022 deri më datë 02 shtator 2022”.

Në lidhje me procedurën e ndjekur kjo prokurori parashtron se kërkesat e shtetasve apo të avokatit për zëvendësimin e prokurorit protokollohen në zyrën e kryesekretarisë, shoqërohen me kartelën shoqëruese të praktikës dhe përcillen në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk evidentohet që palët e mësipërme të kenë paraqitur kërkesë

¹⁹ Me shkresën nr. 5010/1 prot, datë 28.04.2023 regjistruar pranë Ild me nr. 1172/2, datë 02.05.2023.

për zëvendësimin e prokurorit.

Nga shqyrtimi i 22 kërkesave për zëvendësimin e prokurorëve konstatohet se këto kërkesa janë të paraqitura nga prokurorët me shkrim, të protokolluara me nr. përkatës të protokollit hyrës, të cilat më pas përcillen për t'u regjistruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale.

Kërkesat e prokurorit me objekt *"Deklarimin për heqje dorë"* nga hetimi i procedimit penal, janë mbështetur në kërkesat e nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale *"Heqja dorë e prokurorit"*, pika 1, ku parashikohet se: *"Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njanësie për rastet e parashikuara nga neni 17"*.

Në këto kërkesa pasqyrohen të dhëna në lidhje me procedimin penal, si dhe parashtrohet shkak për të cilin bëhet deklarimi i heqjes dorë dhe zëvendësimi me një prokuror tjetër. Këto kërkesa janë të mbështetura si bazë ligjore në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale dhe prokurori ka parashtruar shkakun për heqjen dorë nga hetimi sipas pikave përkatëse të parashikuara në nenin 17 të K. Pr. P. (shkronjat a, b, c, d, e, ë).

Nga 22 (njëzet e dy) kërkesat e paraqitura për heqjen dorë të prokurorit nga hetimi i procedimit penal rezulton se ato janë paraqitur sipas objektit të kërkesës:

- 3 (tre) kërkesa me objekt *"Heqja dorë e prokurorit"* në lidhje me hetimin e procedimeve penale, duke parashtruar si shkak *"Ngarkesën në punë"*.
- 1 (një) kërkesë *"Heqja dorë e prokurorit"*, duke parashtruar si shkak *"Respektim të procesit të rregullt ligjor sepse të pandehurin (xx) e ka pasur në procedim disa herë"*;
- 2 (dy) kërkesa *"Heqja dorë e prokurorit"*, duke parashtruar si shkak *"Pala kërkuese nuk ka besim dhe ka kërkuar përjashtim publikisht në emisionin investigativ "STOP"*;
- 1 (një) kërkesë *"Heqja dorë e prokurorit"*, duke parashtruar si shkak *"Viktima e veprës penale është i afërm i pronarit të banesës ku prokurorja jeton me qira"*;
- 1 (një) kërkesë *"Heqja dorë e prokurorit"*, duke parashtruar si shkak *"Arsye shëndetësore, ngarkesë gatishmërie"*.
- 14 (katërmëdhjetë) kërkesa janë me objekt *"Heqja dorë e prokurorit"* në lidhje me hetimin e procedimit penal përkatës, duke parashtruar si shkak: *"Kalim procedimi te seksioni i të miturve ose dhunë në familje"*, dhe në kërkesa është arsyetuar se kjo konsiston në respektim të standardeve ligjore, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe urdhrin për ndarjen e seksioneve.

Nga kërkesat e mësipërme, 6 (gjashtë) kërkesa janë të paraqitura nga prokurori i gatshëm (gjatë muajit gusht), të cilat më pas janë zëvendësuar (në muajin shtator) me prokurorët e seksioneve të cilave u përkasin këto procedime penale, sipas Urdhrit nr. 85, datë 29.07.2022, të drejtuesit të prokurorisë *"Për organizimin dhe funksionimin e punës, delegimin e kompetencave si dhe dhënien e lejeve të zakonshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë pushimeve vjetore nga data 1 gusht 2022 deri më datë 2*

shtator 2022". Urdhri i drejtuesit është nxjerrë ndër të tjera në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori". Në këtë udhëzim në kreun IV në lidhje me rishpërndarjen e çështjeve parashikohet ndër të tjera se:

- "Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t'i caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysht një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës".

Duke iu referuar numrit dhe datës së protokollit rezulton se të 22 (njëzet e dy) kërkesat e paraqitura për heqjen dorë të prokurorit janë kaluar menjëherë tek drejtuesi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe palët janë njohur më këtë vendim pa vonesë. Në analizë të kërkesës veprimet procedurale për heqje dorë nga hetimi i një çështjeje të caktuar nga ana e prokurorit janë mbështetur në shkaqe të përligjura objektive, me qëllim dhënien e garancive të nevojshme për hetim të paanshëm, përmes mënjanimit të çdo dyshimi të ngritur nga palët pjesëmarrëse ose jo në procedim, sikurse janë rastet kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 12, datë 13.04.2007; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor ky parim duhet të ndiqet edhe gjatë procesit të hetimit.

Nga analizimi i 22 vendimeve të marra nga drejtuesi për "Shqyrtimin e kërkesës me shkrim për pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit" konstatohet se në to pasqyrohen të dhëna në lidhje me kërkesën e prokurorit që ka hetuar procedimin penal, shkakun e paraqitur nga prokurori. Drejtuesi në të gjitha vendimet ka argumentuar arsyet për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit duke parashtruar: "... se në dhënien e drejtësisë është e rëndësishme jo vetëm dhënia e saj në bazë të ligjit, por edhe që për palët në proces dhe për publikun të krijohet një perceptim sa më i plotë se kjo drejtësi do të jepet". Në vendimet e administruara drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 17, 26-27, të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit në lidhje me procedimin penal të referuar në kërkesë dhe zëvendësimin me një prokuror tjetër duke përcaktuar sipas rastit seksionin përkatës, nëpërmjet shortit. Me këtë vendim është njohur drejtuesi i seksionit përkatës dhe njëkohësisht prokurori i cili ka paraqitur kërkesën.

Në të 22 vendimet e drejtuesit është përcaktuar në pikën 4 se: "Kancelarja dhe Sekretarja e Regjistrimit të marrin masa për të bërë veprimet dhe shënimet përkatëse në regjistra elektronikë dhe fizikë si dhe hedhjen e materialit në short, nën drejtimin e drejtuesit të seksionit".

Në analizë të vendimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, rezulton se këto vendime janë marrë në

analizë të shkaqeve të paraqitura në kërkesat individuale, duke iu referuar shkaqeve të pasqyruara në këto kërkesa, por edhe shkaqeve të tjera ligjore për zëvendësimin e prokurorit, duke u bërë vlerësimet përkatëse rast pas rasti nga drejtuesi i prokurorisë.

Neni 27 i K. Pr. Penale “Rastet e zëvendësimit të prokurorit” në pikën 1 parashikohet se “Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit, kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera, prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij”.

Nga analiza e vendimeve të marra nga Drejtuesi i Prokurorisë, në lidhje me arsyet mbi të cilat prokurori që ka paraqitur kërkesë rezulton si më poshtë:

- Në 4 (katër) vendime drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori, në mbështetje të nenit 17, pika “ë”: “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie” dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, për këto shkaqe:
 - prokurori ka hequr dorë për arsye se të pandehurin (x.x) e ka pasur në procedim disa herë.
 - pala kërkuese nuk ka besim tek prokurori dhe ka kërkuar përjashtim publikisht në emisionin investigativ “STOP”.
 - pronari i banesës ku prokurorja jeton me qira ka lidhje gjinie me viktimën e veprës penale (djalë xhaxhai).
- Në 14 vendime drejtuesi ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori për arsye se çështja duhet të hetohet nga prokurorët e seksionit për të mitur.

Në lidhje me 18 vendimet e mësipërme shkak i kërkesës së prokurorit për heqje dorë është i njëjtë me shkakun për të cilin drejtuesi ka argumentuar pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, në zbatim të neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në 4 vendime drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori për arsye të ngarkesës në punë dhe në një rast tjetër është paraqitur si shkak ngarkesa në punë dhe arsye shëndetësorë. Në këto 4 vendime evidentohet fakti se drejtuesi i prokurorisë ka zbatuar nenin 17, germa “ë” të K. Pr. Penale, i cili citon: “Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie””.

Në këto vendime kërkesa e prokurorit lidhet me ngarkesën në punë, shkak i cili është i

paargumentuar nga prokurori. Drejtuesi ka vendosur pranimin e kërkesës pa argumentuar sa është ngarkesa në punë e prokurorit në krahasim me prokurorët e tjerë dhe seksionin përkatës. Neni ku drejtuesi është referuar, konkretisht 17, germa “ë”, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjit nr. 97/2016 nuk parashikon si shkak ngarkesën në punë, por parashikon ekzistencën e shkaqeve të tjera të rëndësishme njëanshmërie, të cilat nuk lidhen me objektin e kërkesës së prokurorit. Ngarkesa në punë nuk parashikohet ndër shkaqet ligjore për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, por si raste të veçanta, ku ngarkesa e madhe apo kompleksiteti i çështjeve dhe për arsye të justifikuara, drejtuesi i prokurorisë vlerëson të përjashtojë prokurorin nga pjesëmarrja në short me urdhër të arsyetuar.

Kjo është parashikuar në Udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në kreun IV parashikohet ndër të tjera se: “*Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t'i caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysht një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës*”.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan evidentohet fakti i zbatimit të praktikës së rregullt për përcjelljen e kërkesës së prokurorit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Drejtuesi pas marrjes së kërkesës ka proceduar me marrjen e vendimit për “*Pranimin ose jo të kërkesës për zëvendësimin e prokurorit...*”, vendim i cili është protokolluar në sekretari.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se vendimet e drejtuesit mbi pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit kanë numrat përkatës të protokollit, datën e regjistrimit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, si dhe procesverbalin nr. __, datë __. __. __ “Për hedhjen në short të çështjeve penale” në short manual. Vendimi u është komunikuar prokurorit dhe palëve për të gjitha rastet.

Në këtë prokurori e gjithë praktika e mësipërme regjistrohet në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale së bashku me kartelën e praktikës, si dhe nga dokumentacioni i përcjellë në ILD rezulton se praktika është e plotë, fakt i cili ndikon në funksion të mbarëvajtjes së punës në këtë prokurori.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në zbatim të neni 26 të Kodit të Procedurës Penale “*Heqja dorë e prokurorit*”, pika 2⁰, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk ka pasur raste kur palët të kenë paraqitur kërkesa për zëvendësimin ose heqjen dorë të prokurorit dhe drejtuesit nga një procedim penal që kanë pasur në hetim.

Gjatë kryerjes së inspektimit, duke iu referuar kopjes së raportit vjetor për vitin 2022 të

²⁰ Mbi deklarimin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më të lartë.

Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se në këtë prokurori gjatë vitit 2022 janë hetuar një numër prej 1770²¹ procedimesh penale, ngarkesë që është përballuar nga prokurorët e kësaj prokurorie me efikasitet pavarësisht pakësimit të numrit të prokurorëve në organikën e kësaj prokurorie.

Raporti vjetor i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan mbi ecurinë e punës në prokurori për vitin 2022 është botuar në faqen zyrtare të kësaj prokurorie. Midis të tjerave në raport është pasqyruar edhe zëvendësimi i prokurorit ku parashtrohet se: *“Në rastet që qytetarët apo subjektet e tjera, kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, apo edhe kur vetë prokurorët kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e tyre, nga ushtrimi i ndjekjes penale në çështje të caktuara, nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, është proceduar me marrjen e vendimeve përkatëse, në respektim të dispozitave procedurale penale, neni 16 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale²²”.*

Për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin 14 prokurorë²³ nga 25 prokurorë që është organika, kjo edhe për faktin e largimit nga detyra²⁴ të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është disponuar me Urdhër nr. 16, datë 26.01.2022, “Për trajtimin e materialeve të prokurorëve B. N., dhe E. T.”; Urdhër nr. 37, datë 04.03.2022, “Për trajtimin e materialeve të dorëzuara nga prokurori E. B.”. Në këto raste nuk është proceduar me zëvendësim prokurori.

Drejtuesi i prokurorisë është bazuar në Urdhër nr. 25, datë 11.02.2019 “Për dorëzimin e dokumentacionit dhe ambienteve” të Prokurorit të Përgjithshëm. Drejtuesi në bazë dhe për zbatim të këtij urdhri ka nxjerrë urdhër për procedurën që duhet të kryhet në kryerjen e dorëzimeve të dosjeve, dokumentacionit dhe bazës materiale. Kjo procedurë është ndjekur për çdo prokuror të larguar pavarësisht shkakut të largimit, të tillë si shkarkim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, komandim etj.

Procedura e zëvendësimit me short manual apo elektronik është mbështetur në Udhëzimin e Përgjithshëm të drejtuesit të prokurorisë nr. 15, datë 26.01.2022 “Mbi rregullshmërinë e mbajtjes dhe depozitimit të akteve procedurale dhe regjistrave të Prokurorisë”. Ky udhëzim ka dalë në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm.

²¹ Faqe 8 e Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë.

²² Faqe 24 e raportit vjetor.

²³ Fq. 120 e raportit.

²⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 516, datë 03.03.2022 ka vendosur të shkarkojë prokurorin z. Ervin Beqiri nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe me vendimin nr. 534, datë 23.05.2022 ka vendosur të shkarkojë prokuroren znj. Elveta Stafa (Murra) nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

B. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik²⁵, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër vendosi në dispozicion kopje të njësuara të praktikave të zëvendësimit të prokurorit, e cila përfshin kërkesë të prokurorit për heqje dorë, vendim për shqyrtimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit, dhe procesverbal shorti për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, si dhe një kopje të *“Regjistrin të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale”*. Gjithashtu u vendos në dispozicion Urdhri nr. 2, datë 07.01.2021, *“Për miratimin e Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”* i drejtuesit të prokurorisë.

Në lidhje me procedurën e ndjekur kjo prokurori parashtron se kërkesat e shtetasve apo të avokatit për zëvendësimin e prokurorit protokollohen në Zyrën e Koordinatorit, ku palët në proces mund të kërkojnë informacion në lidhje me prokurorin që i ka rënë në short çështja, të cilat më pas shoqërohen me kartelën shoqëruese të praktikës dhe përcillen në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk evidentohet që palët e mësipërme të kenë paraqitur kërkesë për zëvendësimin e prokurorit.

Në lidhje me procedurën e ndjekur në këtë prokurori, nga shqyrtimi i të 32 kërkesave me shkrim për heqje dorë nga prokurorët, kërkesa pasi protokollohet në *“Regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me drejtuesin e prokurorisë”* në zyrën e kryesekretarisë, kalon tek sekretarja e drejtuesit. Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim mbi deklarin e prokurorëve për heqje dorë apo të iniciuar nga kërkesa e palët e interesuara. Me vendimin që pranon deklarin e heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër, duke e kaluar dosjen me vendim në Kryesekretari për t’u hedhur në short ndërmjet prokurorëve të tjerë të atij seksioni. Një kopje e vendimit që pranon heqjen dorë i dorëzohet edhe prokurorit të dorëhequr.

Kërkesat e prokurorit me objekt *“Deklarimin për heqje dorë”* nga hetimi i procedimit penal, janë mbështetur në kërkesat e nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale *“Heqja dorë e prokurorit”*, pika 1, ku parashikohet se: *“Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17.”*

Në këto kërkesa pasqyrohen të dhëna në lidhje me procedimin penal, si dhe parashtrohet shkakun për të cilin kërkohet heqja dorë dhe zëvendësimi me një prokuror tjetër. Këto kërkesa janë të mbështetura si bazë ligjore në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale dhe prokurori ka parashtruar shkakun për heqjen dorë nga hetimi sipas pikave përkatëse të parashikuara në nenin 17 të K. Pr. Penale (shkronjat a, b, c, d, e, ë).

²⁵ Me shkresën nr. 6205/1 prot., datë 28.07.2023, regjistruar pranë ILD me nr. 2198/7 prot., datë 02.08.2023.

Nga 32 (tridhjetë e dy) kërkesat e paraqitura për heqjen dorë të prokurorit nga hetimi i procedimit penal rezulton se ato janë paraqitur sipas objektit të kërkesës:

- 7 (shtatë) kërkesa me objekt heqjen dorë dhe zëvendësim prokurori në lidhje me hetimin e procedimeve penale, duke parashtruar si shkak “*Ngarkesën në punë*”;
- 10 (dhjetë) kërkesa me objekt heqjen dorë dhe zëvendësim prokurori në lidhje me hetimin e procedimeve penale, duke parashtruar si shkak “*Konflikt interesi fakti, lidhje familjare dhe pasi drejtoresha e Institucionit të kallëzuar është bashkëshorte e prokurorit*”;
- 4 (katër) kërkesa për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, duke parashtruar si shkak “*Konflikt interesi në dukje pasi kallëzuesit kanë ngritur pretendime dhe kallëzime ndaj prokurores edhe më parë*”;
- 3 (tre) kërkesa për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, duke parashtruar si shkak “*Konflikt interesi në dukje pasi bashkëshorti i prokurores ka njohje të afërt me personin nën hetim*” dhe “*Lidhje farefisnore*”;
- 1 (një) kërkesë për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, duke parashtruar si shkak “*Palët kanë bërë kërkesë për përjashtim prokurori disa herë ndaj dhe prokurori ka hequr dorë*”;
- 7 (shtatë) kërkesa për heqje dorë dhe zëvendësim të prokurorit për procedime penale të trajtuara nga prokurori i gatshëm, të cilat më pas janë zëvendësuar me prokuroren e seksionit të të miturve të cilave u përkasin këto procedime penale. Në këtë rast këto kërkesa për zëvendësim prokurori që i përkasin seksionit për të miturit janë marrë në respektim të standardeve ligjore, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe urdhrin për ndarjen e seksioneve.

Drejtuesi i Prokurorisë mbi të 32 (tridhjetë e dy) kërkesat e paraqitura nga prokurorët me objekt: “*Deklarimin për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, mbështetur në kërkesat e nenit 26, pika 2 të Kodit të Procedurës, i cili parashikon “*Mbi deklarin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë...*” ka disponuar me 32 vendime. Këto vendime janë të dorëzuara nga Drejtuesi i Prokurorisë në Sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të cilat janë të protokolluara. Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë 32 vendime për zëvendësimin dhe shortimin manualisht të materialeve të dorëzuara. Në vijim, nga sekretari i regjistrin janë bërë shënimet e zëvendësimit të prokurorit në regjistrin elektronik dhe manual të kallëzimeve dhe procedimeve penale.

Në analizë të kërkesës së prokurorit, veprimet procedurale për heqje dorë nga hetimi i një çështjeje të caktuar, për shkaqe të përligjura, që vënë në dyshim mungesën e paanësisë në hetim, nëse janë të drejta dhe janë ushtruar në mënyrë individuale janë vlerësuar rast pas rasti nga drejtuesi i prokurorisë.

Në nenin 43²⁶ të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” janë përcaktuar kompetencat e drejtuesit të prokurorisë në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale, ku midis të tjerave është parashikuar në pikën d): “merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj”;

Drejtuesi i prokurorisë në 32 vendimet e marra ka arsyetuar se *shkaqet që paraqesin në kërkesën e prokurorit me objekt: “Deklarimin për heqje dorë”* parashikohen në rastet e listuara në nenet 15-18 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 27²⁷ “Rastet e zëvendësimit të prokurorit” në pikën 1, përcakton qartë rastet e zëvendësimit të prokurorit: “Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit, kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera, prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij”.

Nga analiza e vendimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë, në lidhje me shkaqet mbi të cilat prokurori që ka paraqitur kërkesë është vendosur zëvendësimi i prokurorit në një procedim penal të caktuar, nga arsyet e përcaktuara rezultojnë se:

- Drejtuesi i prokurorisë ka pranuar me vendim heqjen dorë dhe zëvendësim të prokurorit për 10 (dhjetë) kërkesa në lidhje me hetimin e procedimeve penale dhe zëvendësimin e tij, duke parashtruar si shkak “Konflikt interesi fakti, lidhje familjare”, në zbatim të nenit 17, pika “e” dhe nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të papajtueshmërisë për arsye lidhje familjare, i cili parashikon se: “në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë....”.
- Drejtuesi i prokurorisë në 4 (katër) vendime ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori dhe zëvendësimin e tij për shkakun se në këto procedime prokurorja ndodhet në kushtet e “Konfliktit të interesit në dukje pasi kallëzuesit kanë ngritur pretendime dhe kallëzime ndaj prokurores edhe më parë”, duke argumentuar zbatimin e nenit 17, pika “ë” të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon: “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.
- Në 3 (tre) vendime drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori dhe zëvendësimin e prokurorit, në këto vendime është analizuar shkakun: “Konflikt interesi në dukje pasi bashkëshorti i prokurores ka njohje të afërt me personin nën hetim” dhe “Lidhje farefisnore”, në zbatim të nenit 17, pika “ë” të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “kur

²⁶ Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale.

²⁷ (Ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002; shtuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017).

ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

- Në lidhje me 1 (një) kërkesë të prokurorit për heqje dorë, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, duke parashtruar si shkak *“Palët kanë bërë kërkesë për përjashtim prokurori dhe faktit që janë krijuar rrethana konfliktuale dhe raport problematik me palën e viktimës”* në mbështetje të nenit 17, pika “ç” të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon heqjen dorë *“kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij... me të pandehurin ose njërën prej palëve private”*.

Në këto vendime drejtuesi i prokurorisë për të shmangur çdo lloj dyshimi, duke njëanshmërie apo paragjykim të çështjes, bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale ka vlerësuar pranimin e kërkesës së prokurorit dhe zëvendësimin e tij.

- 7 (shtatë) kërkesa për zëvendësime të prokurorit për procedime penale të trajtuara nga prokurori i gatshëm, të cilat më pas janë zëvendësuar me prokuroren e seksionit të posaçëm për hetimin e veprave penale të kryera nga ose ndaj të miturve. Në këto vendime për zëvendësim prokurori që i përkasin seksionit për të mitur vendimet janë marrë në respektim të standardeve ligjore, neneve 15-17 dhe 24-27 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*.

Në lidhje me 25 (njëzet e pesë) vendimet e mësipërme shkak i kërkesës së prokurorit për heqje dorë është i njëjtë me shkakun për të cilin drejtuesi ka argumentuar zëvendësimin e prokurorit, në zbatim të neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në 7 (shtatë) vendime drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës *“Për heqjen dorë”* të paraqitur nga prokurori për arsye të ngarkesës në punë. Në këto 7 vendime të drejtuesit evidentohet fakti se drejtuesi i prokurorisë në mbështetje të neneve 15-17 dhe 24-27 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenet 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* ka vendosur zëvendësimin e prokurorit për shkak të mbingarkesës në dosje.

Në këto vendime kërkesa e prokurorit lidhet me ngarkesën në punë, shkak i cili është i paargumentuar nga prokurori. Drejtuesi ka vendosur pranimin e kërkesës pa argumentuar sa është ngarkesa në punë e prokurorit në krahasim me prokurorët e tjerë dhe të seksionit përkatës. Nenet 15-17 dhe 24-27 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenet 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* ku drejtuesi është referuar, nuk parashikon si shkak ngarkesën në punë, por parashikon ekzistencën e shkaqeve të tjera të rëndësishme njëanshmërie, të cilat nuk lidhen

me objektin e kërkesës së prokurorit. Në këto raste, drejtuesi i prokurorisë do duhej të vlerësonte ngarkesën e prokurorëve dhe të organizonte rishpërndarjen e çështjeve në short. Kjo është parashikuar në Udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në kreun IV parashikohet ndër të tjera se: “Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do tëi caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysht një trajtim të njëjtë mes prokuroreve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës”.

Neni 49 i ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me zëvendësimin e prokurorit parashikohet: “1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal. 2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore. 3. Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Vendimi për tërheqjen e çështjes i dorëzohet prokurorit përkatës. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kundër vendimit të zëvendësimit, brenda 5 ditëve nga marrja njoftim e tij. Vendimi me shkrim dhe ankimi përkatës janë pjesë e dosjes. 4. Vendimi lidhur me ankimin duhet të merret brenda pesë ditëve nga marrja e tij. 5. Ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Nëse ankimi pranohet, çështja i caktohet sërish prokurorit të cilit i ishte tërhequr”.

Nga aktet e administruara rezulton se nuk është marrë asnjë vendim “Për zëvendësimin e prokurorit” në kundërshtim me nenin 43, pika “d”, të ligjit nr. 97/2016 dhe nenet 16, 17 dhe 27 të K. Pr. Penale.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër evidentohet fakti se në të 32 kërkesat identifikohet momenti i kalimit të kërkesës tek sekretaria e prokurorisë, si dhe procedura për përcjelljen e materialit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Drejtuesi pas marrjes së kërkesës procedon me marrjen e vendimit për “Pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit...”, duke vazhduar me regjistrimin e vendimit në sekretari dhe hedhjen e shortit manual për kalimin e procedimit penal një prokurori tjetër dhe njoftimin e palëve.

Në këtë prokurori praktika e mësipërme regjistrohet në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale së bashku me kartelën e praktikës, si dhe nga dokumentacioni i përcjellë në ILD rezulton se praktika është e plotë, fakt i cili ndikon në funksion të mbarëvajtjes së punës në këtë prokurori.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 , në zbatim të neni 26 të Kodit të Procedurës Penale

“Heqja dorë e prokurorit”, pika 2²⁸, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nuk ka pasur raste kur palët të kenë paraqitur kërkesa për zëvendësimin ose heqjen dorë të prokurorit ose drejtuesit nga një procedim penal që kanë pasur në hetim.

Për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin 11 prokurorë²⁹ nga 19 prokurorë që është organika, kjo edhe për faktin e largimit nga detyra të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në mbështetje të nenit 43, pika d të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj.

- Kaktimi i çështjeve me zëvendësim organizohet nga K/sekretarja, sipas përcaktimeve dhe detyrave të lëna me urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 2, datë 07.01.2021, “Për miratimin e Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”.

- Zëvendësime për procedimet penale të pezulluara të prokurorëve që janë larguar, të cilat kanë ardhur në prokurori për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit.

- Zëvendësime për rastet e procedimeve penale të pezulluara të prokurorëve që janë larguar dhe që janë zbuluar prova të tjera për rifillimin e çështjes.

- Rastet e dosjeve të pezulluara në gjykim të prokurorëve të larguar, për të cilët ka filluar gjykimi.

- Heqje dorë dhe zëvendësime të prokurorëve për shkak të mbingarkesës me dosje dhe pamundësi për kryerjen e hetimeve të plota dhe në kohë zvarritje.

- Raste të tilla janë kur në prokurori janë emëruar prokurorë të rinj dhe kanë pasur një ngarkesë shumë të vogël me dosje në raport me prokurorët që kanë ushtruar prej kohësh detyrën në këtë prokurori. Këta prokurorë kanë qenë të mbingarkuar me dosje për shkak edhe të dosjeve të marra nga prokurorët e pezulluar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

C. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik³⁰ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka informuar se: “... gjatë muajit Korrik është zhvilluar shorti për vlerësimin etiko-profesional të Prokurorëve për një periudhë 3 vjeçare (2017-2019) si dhe inventarizimi i dosjeve të para viteve 1990-2012 të cilat më pas janë transferuar në Tiranë, proces i cili ka kërkuar angazhimin e gjithë

²⁸ Mbi deklarimin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më të lartë.

²⁹ Fq. 120 e raportit.

³⁰ Me shkresën nr. 7195/1 prot., datë 27.07.2023 regjistruar pranë ILD-së me nr. 2198/6 prot., datë 31.07.2023.

personelit mbështetës pasi është bërë nxjerrja/përpunimi i të gjitha dosjeve nga arkiva. Kërkojmë mirëkuptimin tuaj për mosdërgimin e akteve të kërkuara brenda afatit 15 ditor. Aktualisht jemi duke bërë verifikimet në bashkëpunimin dhe me prokurorët, për çdo dosje për marrjen e kopjeve të kërkesave/vendimeve për çdo rast ku është kërkuar heqja dorë nga hetimi, pasi nuk janë mbajtur kopje të vendimeve në arkiv”.

Në vazhdimësi të komunikimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë³¹, vuri në dispozicion praktikën për zëvendësimin e prokurorit, kopje të kërkesës së prokurorëve dhe kopje të vendimit të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësim.

Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë parashtron procedurën që ndiqet në këtë institucion, si dhe informon se zëvendësimi i prokurorit nga hetimi i çështjes kur kërkesa është bërë nga palët ose kur kërkesa paraqitet nga prokurori për dorëheqje nga çështja vlerësohet nga drejtuesi i prokurorisë duke u shprehur me vendim pranimi apo mospranimi.

Kërkesat e prokurorit për zëvendësimin e tij, si dhe vendimi për shqyrtimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit, janë mbështetur në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 16 dhe 17/ë, 24, 26, 27, dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe urdhri nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”. Nga ana e drejtuesit të prokurorisë është nxjerrë urdhri nr. 15, datë 08.09.2022 “Për organizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

Vendimet janë marrë mbi bazën e kërkesës të paraqitur me shkrim nga prokurorët mbi “Deklarimin për heqje dorë” të cilat mbajnë vetëm datën e kërkesës së prokurorit, nuk rezultojnë të dorëzuara në kryesekretarinë e kësaj prokurorie dhe evidentohet të jenë të paprotokolluara në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale.

Nga të 22 (njëzet e dy) kërkesat për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit rezulton se është paraqitur:

- **1 (një) kërkesë** me objekt: Zëvendësim prokurori në lidhje me hetimin e procedimeve penale, duke parashtruar si shkak “Largim prokurori”.
- **4 (katër) kërkesa për shkak të konfliktit të interesit**, konkretisht: **1 (një) kërkesë** për shkak se midis palës në hetim dhe bashkëshortit të prokurores kanë qenë kolegë dhe kanë pasur mosmarrëveshje midis tyre për arsye pune; **2 (dy) kërkesa** për shkak se pala kallëzuese, ka depozituar kallëzim penal dhe një sërë ankesash në institucione të

³¹ Me shkresën nr. 7195/2 prot., datë 19.09.2023 regjistruar pranë ILD-së me nr. 2198/8 prot., datë 22.09.2023.

ndryshme ndaj prokurores në lidhje me çështje që ka pasur më parë në hetim dhe **1 (një)** kërkesë për shkak se nga ana e palës në hetim ka pasur pretendime mbi vendimmarrjen e prokurores në lidhje me një çështje të hetuar më parë.

Në këto vendime drejtuesi i prokurorisë në zbatim të nenit 17, të pika “ç” të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *“kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërën prej palëve private”*, për të shmangur çdo lloj dyshimi, dukje njëanshmërie apo paragjykim të çështjes, bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale ka vlerësuar pranimin e kërkesës së prokurorit dhe zëvendësimin e tij.

- **8 (tetë)** kërkesa janë zëvendësime të prokurorit për procedime penale të trajtuara nga prokurori i gatshëm, të cilat më pas janë zëvendësuar me prokurorin e seksionit të të miturve të cilit i përkasin këto procedime penale. Në këto raste kërkesat për zëvendësim prokurori që i përkasin seksionit për të mitur janë bërë në respektim të standardeve ligjore, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe urdhrin nr. 1, datë 29.01.2021 *“Për organizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”*,
- **7 (shtatë)** kërkesa janë zëvendësime të prokurorit për procedime penale të trajtuara nga prokurori i gatshëm, të cilat më pas janë zëvendësuar me prokurorin e seksionit për hetimin e krimit ekonomik. Në këto vendime për zëvendësim prokurori që i përkasin seksionit të krimit ekonomik, vendimet janë marrë në respektim të standardeve ligjore, neneve 15-17 dhe 24-27 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*.

Në lidhje me 20 (njëzet) vendimet e mësipërme shkak i kërkesës së prokurorit për heqje dorë është i njëjtë me shkakun për të cilin drejtuesi ka argumentuar zëvendësimin e prokurorit, në zbatim të neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale.

- **1 (një)** informacion i prokurores E. L.,³² në lidhje me materialin kallëzues, ku rezulton se në këtë prokurori është duke u hetuar një procedim tjetër me të njëjtët palë dhe objekt hetimi. Në mbështetje të nenit 92 të Kodit të Procedurës Penale³³ prokurorja ka kërkuar bashkimin e materialit kallëzues me procedimin tjetër penal.

³² Informacion i datës 15.09.2022.

³³ 1. Bashkimi i çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë para të njëjtës gjykatë mund të vendoset, kur nuk dëmtohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre: a) në rastet e parashikuara nga neni 79; b) në rastet e veprave penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit; c) në rastet, kur prova e një vepre penale ose e një rrethane të saj ndikon mbi provën e një vepre penale tjetër ose të një rrethane të saj.

- **1 (një)** kërkesë për shkak të ngarkesës në punë.

Në lidhje me 2 vendimet e mësipërme të drejtuesit të prokurorisë rezulton se:

- **1 (një)** vendim “Mbi deklaratën heqje dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale” rezulton se prokurorja nuk ka paraqitur deklaratë për heqje dorë nga materiali kallëzues, por ka paraqitur një informacion për shkak të bashkimit të procedimeve penale, drejtuesi i prokurorisë në mbështetje të neneve 16, 17 “ë”, 24, 26, 27, 277 “Organet e ngarkuara për hetimet paraprake” dhe 110 “Memoriet dhe kërkesat e palëve”³⁴ të Kodit të procedurës Penale të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrit nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullores mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve,” nenet 3, 5, 7, 14 ka vendosur “Të pranojë deklaratën për heqjen dorë të prokurores E. L., nga hetimi i materialit kallëzues...”. Në këtë rast duhej disponuar në zbatim të nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale “Rastet e bashkimit të procedimeve”, ku citohet: *1. Organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve: b) kur një person akuzohet për disa vepra penale”.*
- **1 (një)** vendim për zëvendësimin të prokurorit në procedimin penal “... për shkak të ngarkesës në punë”³⁵, drejtuesi i prokurorisë ka argumentuar ngarkesën në punë të prokurores, numrin e të arrestuarve që ajo ka në hetim, për shkak të natyrës së çështjeve (vrasje, etj...) nuk i është referuar asnjë dispozite ligjore në lidhje me “Deklaratën e heqjes dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale nga prokurorja, por i është referuar ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë vendim kërkesa e prokurorit lidhet me ngarkesën në punë, shkak i cili është i paargumentuar nga prokurori. Drejtuesi ka vendosur pranimin e kërkesës pa argumentuar sa është ngarkesa në punë e prokurorit në krahasim me prokurorët e tjerë dhe të seksionit përkatës. Nenet 15-17 dhe 24-27 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenet 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” ku drejtuesi është referuar, nuk parashikon si shkak ngarkesën në punë, por parashikon ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë për rastet e parashikuara nga nenit 17, të cilat nuk lidhen me objektin e kërkesës së prokurorit. Në këto raste, drejtuesi i prokurorisë duhej të vlerësonte ngarkesën e prokurorëve dhe duhej të organizonte rishpërndarjen e çështjeve në short. Kjo është parashikuar në Udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në kreun IV parashikohet ndër të tjera se: “Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t’i caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysh një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës”.

³⁴ Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim.

2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

³⁵ Vendim mbi deklaratën për heqje dorë të prokurores F. Ç., datë 18.07.2022 (e paprotokolluar).

Neni 49 i ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar se: 3. Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Vendimi për tërheqjen e çështjes i dorëzohet prokurorit përkatës. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kundër vendimit të zëvendësimit, brenda 5 ditëve nga marrja njoftim e tij”. Në këtë prokurori nuk ka pasur asnjë rast të zëvendësimit të prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë.

Me vendimin që pranon deklarinimin e heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë është zëvendësuar me një prokuror tjetër, dhe nuk rezulton të jetë marrë asnjë vendim në kundërshtim me nenin 43, pika “d” të ligjit nr. 97/2016 dhe nenet 16, 17 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë evidentohet fakti se në të 22 (njëzet e dy) kërkesat nuk identifikohet momenti i kalimit të kërkesës tek sekretaria e prokurorisë, si dhe procedura për përcjelljen e materialit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Drejtuesi pas marrjes së kërkesës procedon me marrjen e vendimit për “Pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit...” dhe vetëm në dy raste evidentohet të jetë vazhduar me hedhjen e shortit manual për kalimin e procedimit penal një prokurori tjetër konkretisht procedimi penal nr. 2126, datë 22.11.2022³⁶ dhe kallëzimi penal nr. 2030, datë 04.11.2022³⁷, si dhe njoftimin e palëve.

Në këtë prokurori praktikant e mësipërme nuk rezultojnë të regjistruara së bashku me kartelën e praktikës, si në rastin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Shkodër. Nga dokumentacioni i përcjellë në ILD rezulton se praktika është e paplotë, fakt i cili ka ndikuar në përcjelljen e materialeve pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kuadër të këtij inspektimi tematik.

Për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin 13 prokurore³⁸ nga 19 prokurorë që është organika, kjo edhe për faktin e largimit nga detyra të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.

D. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik³⁹, **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, lidhur me informacionin e kërkuar në kuadër të inspektimit tematik periudha kohore 01.01.2022 deri më 31.12.2022, ka informuar në lidhje me procedurën e ndjekur për

³⁶ Procesverbal mbi hedhjen e shortit datë 01.12.2022.

³⁷ Procesverbal mbi hedhjen e shortit datë 23.11.2022.

³⁸ Fq. 120 e raportit.

³⁹ Me shkresën nr. 8914/1 prot., datë 19.07.2023, regjistruar pranë ILD me nr. 2198/4 prot., datë 05.07.2023.

zëvendësimin e prokurorit si më poshtë:

- Zëvendësimi lidhet kryesisht me faktin që një pjesë e prokurorëve janë shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pas vendimit të shkarkimit nxirret urdhër nga drejtuesi i institucionit për hedhjen në short të çështjeve në hetim, gjykim dhe të materialeve kallëzuese.
- Në lidhje me rastet kur kërkesa për zëvendësim bëhet nga palët, fillimisht protokollohet në librin e brendshëm të kërkesë/ankesave, më pas materiali shkon për vlerësim të drejtuesi i prokurorisë i cili pasi shqyrton kërkesën, i kërkon prokurorit të çështjes që të paraqesë mendim me shkrim. Pasi shqyrton pretendimet e palës dhe prokurorit merr vendimin për pranim ose refuzim. Në rast pranimi dosja kalon për rishortim elektronik.
Vendimmarrja dhe njoftimi i palës bëhet nga ana e prokurorit, praktikë e cila administrohet në fashikullin penal.
- Rast tjetër zëvendësimi është kur prokurori paraqet kërkesën për heqjen dorë për arsye si më poshtë:
 1. Për shkak të natyrës së veprës penale pasi nuk përfshihet në seksionin që prokurori mbulon.
 2. Për shkak të konfliktit të interesit me njërin nga palët.
 3. Për shkak se pala ka paraqitur ankesa të vazhdueshme për veprimet hetimore të kryera nga prokurori.

Në lidhje me pikën 2 dhe pikën 3, argumentohet se: *“vendimi i zëvendësimit është në fashikullin penal që administrohet nga prokurori ose zyra e arkivës. Duke qenë se jemi në pamundësi objektive për të identifikuar rastet konkrete, nuk mund t’ua vëmë në dispozicion”*. Në vazhdimësi të informacionit është sqaruar se: *“Në lidhje me vendimmarrjen për zëvendësim ose kërkesën për heqje dorë, duke filluar nga viti 2023 është krijuar regjistri elektronik dhe ruhet një kopje e vendimit , për këtë arsye për vitin 2022 nuk kemi të dhëna sa kërkesa të kësaj natyre janë paraqitur dhe në cilët fashikuj penal janë të administruar”*.

Bashkëlidhur këtij informacioni janë dërguar urdhrat e nxjerrë nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Pavarësisht parashikimeve ligjore evidentohet fakti se është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të kërkesës së arsyetuar nga prokurori tek drejtuesi i prokurorisë, për faktin se për vitin 2022 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk ka të dhëna sa kërkesa të kësaj natyre janë paraqitur dhe në cilët fashikuj penal janë të administruar.

Gjatë kryerjes se inspektimit lidhur me vendimet e marra nga drejtuesit e prokurorive rezulton se gjatë periudhës së inspektimit, rezulton se numrin më të madh të kërkesave e ka prokuroria Shkodër, prokuroria Elbasan dhe Vlorë, ndërsa për Prokurorinë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk kemi asnjë informacion.

Në kuadër të një analize të gjithanshme mbi situatën faktike të gjendjes së prokurorive objekt inspektimi u krijua një panoramë e plotë mbi praktikën dhe shkaqet në lidhje me *deklarimin e prokurorëve për plotësimin e kërkesave ligjore të parashikuara në nenet 16, 17 të Kodit të Procedurës Penale, vendimit të drejtuesit të prokurorisë, arsyetimit të vendimeve në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore të parashikuara nga nenet 26/1 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe komunikimin e vendimit palëve dhe hedhjes në short të kallëzimit apo procedimit penal.*

III. Gjetjet e inspektimit

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, trajtimi në mënyrë shteruese i problematikave të dala gjatë realizimit të inspektimit rezulton se:

i. Sa i përket problematikave të konstatuara gjatë inspektimit të hasura në lidhje me kërkesat ose deklarimet me objekt "Heqje dorë" të prokurorit dhe vendimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë për pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit duhet mbajtur në konsideratë se një faktor i rëndësishëm është edhe situata reale e administratës në të katër prokuroritë objekt inspektimi. Vlen të përmendet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër, të cilat kanë zbatuar me përpikmëri procedurën e ndjekur në rastet e kërkesave dhe vendimeve të marra për zëvendësimin e prokurorit, si dhe administrimit të dokumentacionit të plotë të këtyre praktikave. Kjo e lidhur me mënyrën e organizimit të punës, realizimit të detyrave nga stafi përgjegjës i administratës së prokurorisë, përgjegjësia e kryesekretarit për protokollimin e kërkesës së depozituar nga palët (subjekte të procedimit penal), regjistrimin e saj në regjistrin e dorëzimit të kërkesës, të pasqyrit të lëvizjes së kërkesës, kalimi i saj te drejtuesi i prokurorisë dhe dorëzimi i arsyetuar i vendimit të marrë nga drejtuesi, njoftimi i palëve, deri te hedhja e shortit për zëvendësimin e prokurorit.

Marrë në konsideratë sa më sipër, pavarësisht parashikimeve ligjore evidentohet fakti se gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmbledhur problematika të lidhura me:

- Paraqitjen e paplotë të informacionit të kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë, në lidhje me dokumentacionin e kërkesave të paraqitura nga prokurorët, palët në procesin penal (i pandehuri, avokati, viktimi nga vepra penale) me objekt mbi: "*Zëvendësimin e Prokurorit*", duke u paraqitur si shkak mosmbajtja më vete e këtyre praktikave.
- Mosparaqitjen e informacionit dhe dokumentacionit me të dhënat e kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi në lidhje me vendimet e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Tiranë për zëvendësimin e prokurorit, me shkakun se : “... është në fashikullin penal që administrohet nga prokurori ose zyra e arkivës. Duke qenë se jemi në pamundësi objektive për të identifikuar rastet konkrete, nuk mund t'ua vëmë në dispozicion”.

- Mosparaqitjen e informacionit dhe dokumentacionit me të dhënat e kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi në lidhje me vendimet e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për zëvendësimin e prokurorit, me shkakun se : “Aktualisht jemi duke bërë verifikimet në bashkëpunimin dhe me prokurorët, për çdo dosje për marrjen e kopjeve të kërkesave/vendimeve për çdo rast ku është kërkuar heqja dorë nga hetimi, pasi nuk janë mbajtur kopje të vendimeve në arkiv”.

➤ **Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan**

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të deklarimeve të prokurorëve me objekt “Heqjen dorë” nga hetimi në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të kërkesës, protokollimi i saj dhe kalimi te drejtuesi i prokurorisë, vendimi i drejtuesit të prokurorisë protokollimi i tij, njohja e palëve me këtë vendim deri në hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit në kryesekretarinë e kësaj prokurorie. Nga analiza vjetore për vitin 2022 të kësaj prokurorie rezulton se rastet e zëvendësimit të prokurorëve zënë 0.01% - 0.02 në ngarkesën e përgjithshme të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, janë përpunuar dhe trajtuar në zbatim të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat motivojnë paraqitjen e deklarimit për heqjen dorë të prokurorit. Megjithëse nga ana e prokurorit janë ofruar të gjitha garancitë e nevojshme për palët gjatë procesit të hetimit, në momentin e konstatimit të ekzistencës së një arsye njëanshmërie, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, ai ka paraqitur deklarinimin për “Heqje dorë”.

Nga përpunimi i të dhënave për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022 janë paraqitur 22 kërkesa nga prokurorët me objekt “Heqje dorë”, të cilat janë dorëzuar në kryesekretari, janë regjistruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale ku secila kërkesë ka nr. e protokollit përkatës, në kolonën “Dhënia e informacionit nga prokurori” dhe datën e kalimit nga prokurori Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i cili regjistrohet në librin e protokollit të komunikimeve të brendshme.

Drejtuesi i prokurorisë në mbështetje të nenit 26, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale

ka vlerësuar se, shkak i pretenduar nga ana e kërkuarit (që në rastin konkret ka qenë prokurori) përfshihet në kategorinë e shkaqeve procedurale të sanksionuara në nenet 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, ka arsyetuar duke vendosur pranimin e kërkesës, kalimin e akteve të dosjes në hedhjen e shortit manual dhe njoftimin e vendimit palëve (prokurorit që ka paraqitur kërkesë dhe prokurorit që i ka kaluar në short).

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, lidhur me 22 vendimet mbi pranimin e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit nga Drejtuesi i Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nuk është evidentuar asnjë rast që të jetë vendosur kryesisht nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit, në bazë të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale.

➤ **Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.**

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të kërkesave të prokurorëve me objekt për heqjen dorë nga hetimi në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të kërkesës protokollimi i saj dhe kalimi te drejtuesi i prokurorisë, vendimi i drejtuesit të prokurorisë, protokollimi i tij, njohja e palëve me këtë vendim, deri në hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit në kryesekretarinë e kësaj prokurorie.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë përpunuar dhe trajtuar në zbatim të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat motivojnë paraqitjen e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit.

Për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 janë depozituar në sekretari 32 (tridhjetë e dy) kërkesa me shkrim me objekt: “*Deklarimin për heqje dorë*” nga hetimi i procedimit penal, të paraqitur me shkrim nga prokurorët të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj prokurorie.

➤ **Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.**

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të deklarimeve të prokurorëve me objekt për heqjen dorë nga hetimi në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të kërkesës protokollimi i saj dhe kalimi te drejtuesi i prokurorisë, vendimi i drejtuesit të prokurorisë, protokollimi i tij, njohja e palëve me këtë vendim, deri në hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit në kryesekretarinë e kësaj prokurorie.

Nga analiza vjetore për vitin 2022 e kësaj prokurorie rezulton se rastet e zëvendësimit të prokurorëve zënë 0.02% në ngarkesën e përgjithshme të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 janë paraqitur 22 (njëzet e dy) deklarime për "Heqjen dorë" nga hetimi i procedimit penal, të paraqitur nga prokurorët e kësaj prokurorie për shkaqe të ndryshme, të cilat na janë vënë në dispozicion.

Gjatë përpunimit të të dhënave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë u vunë re problematika në lidhje me mbajtjen e praktikave për përcjelljen e deklarimit të prokurorit për heqjen dorë në zyrën e drejtuesit të prokurorisë. Deklarimet janë paraqitur me shkrim nga prokurorët mbi "Heqjen dorë", të cilat mbajnë vetëm datën e deklarimit të prokurorit, nuk rezultojnë të dorëzuara në kryesekretarinë e kësaj prokurorie dhe evidentohet të jenë të paprotokolluara.

Vendimet e drejtuesit janë të paprotokolluara dhe të panjoftuara palëve. Në lidhje me vazhdimin e procedurës për zëvendësimin e prokurorit vetëm në dy raste evidentohet të jetë vazhduar me hedhjen e shortit manual për kalimin e procedimit penal një prokurori tjetër konkretisht procedimi penal nr. 2126, datë 22.11.2022 dhe kallëzimi penal nr. 2030, datë 04.11.2022. Në rastet e tjera nuk pasqyrohet pjesë e praktikës procesverbali në lidhje me hedhjen e shortit pas marrjes së vendimit të drejtuesit për kalimin e akteve të procedimit penal pas zëvendësimit të prokurorit.

➤ **Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.**

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nuk arriti të ketë asnjë informacion dhe dokumentacion në lidhje me deklarimet e paraqitura nga prokurorët për heqjen dorë nga hetimi dhe asnjë vendim të marrë nga drejtuesi i prokurorisë në lidhje me këto deklarime.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁴⁰, parashtojnë informacionin në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit për periudhën e kërkuar, i shoqëruar ky informacion me të dhëna të pjesshme, vetëm për zëvendësimin e prokurorit për të gjitha rastet kur prokurori është shkarkuar me vendim të KPK-së ose KPA-së, të dhëna këto të cilat janë nxjerrë nga regjistri elektronik dhe paraqiten në formë të listuar, të pashoqëruara me asnjë akt procedural.

Nga informacioni i dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit për

⁴⁰ shkresën nr. 8914/1, datë 19.07.2023.

periudhën e kërkuar, nuk ka të dhëna dhe nga regjistri i dërguar nuk rezultojnë të hedhura deklarime për heqje dorë dhe vendime për zëvendësimin e prokurorit.

Kjo mungesë dokumentacioni shpjegohet me faktin se vendimmarrja dhe njoftimi i palës bëhet nga ana e prokurorit, praktikë e cila administrohet në fashikullin penal dhe nuk administrohet asnjë praktikë në rastet e deklarimit për heqje dorë të prokurorit dhe vendimit e pranimit ose jo nga drejtuesi. Për këtë fakt, nuk u realizua nga grupi i inspektorëve analiza mbi objektin e inspektimit “*Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022*” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sikurse u trajtua dhe në rubrikën e analizës ligjore të këtij raporti, një nga problematikat e konstatuara gjatë inspektimit është mënyra e organizimit dhe realizimit të detyrave nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë objekt inspektimi.

Nga kontrolli i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë, gjatë inspektimit, u hasën problematikat e mëposhtme:

1. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezultoi:
 - a. Mungesa e plotë e dokumentacionit si dhe kopje të deklarimeve të prokurorit për heqjen dorë nga hetimi në bazë të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale dhe asnjë dokumentacion në lidhje me regjistrimin e këtyre deklarime në kryesekretari.
 - b. Mungesa e dokumentacionit si vendimet e drejtuesit që ka pranuar deklarimin për zëvendësimin e prokurorit, kopje të fletës së regjistrimit ku pasqyrohet vendimi i protokolluar, njoftimi i palëve (prokurori të cilit i është pranuar kërkesa dhe prokurorit të cilit i ka rënë shorti), si dhe kopje e formularit pas rishortimit të çështjes në rastet kur kërkesa për zëvendësim është pranuar.
 - c. Gjatë inspektimit u konstatua se nga regjistri i pasqyrimin të lëvizjes (*pra kalimi i deklarimit për heqje dorë deri te dorëzimi i vendimit nga drejtuesi i prokurorisë*) në Prokurorinë Tiranë nuk rezulton të kemi asnjë informacion për pasqyrimin e tyre, si dhe kërkesat apo vendimet e protokolluara, të cilat nuk janë paraqitur para ILD-së, në funksion të mbarëvajtjes së punës në këtë institucion.
 - d. Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, nuk ka të dhëna të sakta për mënyrën e trajtimit të vendimeve të komunikuar palëve, duke bërë të pamundur nxjerrjen e këtij informacioni edhe nga vetë prokuroria. Ekzistenca e një regjistri në të cilën do të shënoheshin data dhe dita e komunikimit të secilit vendim do të lehtësonte punën e administratës dhe njohjen e palëve të interesuara mbi këto të dhëna.
 - e. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Tiranë nuk është mbajtur në arkivë një kopje e këtyre praktikave, për faktin e pretenduar në informacionin e dërguar pranë ILD-së se “*Vendimmarrja dhe njoftimi i palës bëhet nga ana e prokurorit, praktikë e cila administrohet në fashikullin penal*”⁴¹”.

2. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë rezultoi:
 - a. Gjatë inspektimit u konstatua se nga regjistri i pasqyrimin të lëvizjes (*pra kalimi i deklaramit për heqje dorë deri te dorëzimi i vendimit nga drejtuesi i prokurorisë*) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk rezulton të kemi asnjë informacion për pasqyrimin e tyre, në funksion të mbarëvajtjes së punës në këtë institucion.
 - b. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë deklaramet e prokurorit për heqjen dorë janë të paprotokolluara dhe të paregjistruara.
 - c. Vendimi i drejtuesit të prokurorisë nuk është i protokolluar në kryesekretari dhe nuk ka njoftim të palëve me këtë vendim.
 - d. Pas marrjes së vendimit për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, procedimi penal ka kaluar tek një prokuror tjetër, ku mungon procesverbali i shortit.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk ka mbajtur në arkivë një kopje të këtyre praktikave, që nga momenti i kalimit të kërkesës së arsyetuar të prokurorit për heqje dorë si me vendimin e arsyetuar nga drejtuesi i prokurorisë tek sekretaria dhe hedhjen në short për zëvendësimin e prokurorit, për faktin se:⁴² “*Aktualisht jemi duke bërë verifikimet në bashkëpunimin dhe me prokurorët, për çdo dosje për marrjen e kopjeve të kërkesave/vendimeve për çdo rast ku është kërkuar heqja dorë nga hetimi, pasi nuk janë mbajtur kopje të vendimeve në arkiv*”.

Nga inspektimi rezultoi se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër, është identifikuar një praktikë e plotë në respektim të formës dhe përmbajtjes, duke iu referuar shkaqeve të bazuara në nenet 17, 26 të Kodit të Procedurës Penale. Në pranimin e kërkesës nga drejtuesi i këtyre dy prokurorive është argumentuar sipas rastit shkak për të cilin është kërkuar zëvendësimi i prokurorit dhe nëse ky shkak përfshihet në kategorinë e shkaqeve procedurale të sanksionuara në nenet 15, 16 dhe 17 të K. Pr. Penale, të cilat lidhen me nocionin e një hetimi të paanshëm.

⁴¹ Me shkresën nr. 8914/1 prot., datë 19.07.2023, të Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila është regjistruar pranë ILD-së me nr. 2198/4 prot., datë 20.07.2023.

⁴² Me shkresën nr. 7195/1 prot., datë 27.07.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e cila është regjistruar pranë ILD-së me nr. 2198/6 prot., datë 31.07.2023.

Rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër të inspektuara treguan gatishmëri në bashkëpunimin për këtë inspektim tematik, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përcolli një informacion dhe dokumentacion jo të plotë, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk përcolli pranë ILD-së dokumentacion të plotë në lidhje me këtë inspektim tematik.

IV. Konkluzionet

- Të gjitha deklaratimet për “Heqjen dorë” nga hetimi i procedimit penal të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Shkodër dhe Vlorë janë të paraqitura nga prokurorët e këtyre prokurorive dhe në asnjë rast nga palët e tjera të procedimit penal ku të jetë kërkuar heqja dorë e prokurorit ose zëvendësimi i tij nga hetimi i një procedimi penal.
- Me paraqitjen e kërkesave të prokurorëve për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër është proceduar me regjistrimin e tyre në zyrën e protokollit dhe më pas në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale.
Kjo procedurë nuk është ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë objekt i këtij inspektimi.
- Referuar dokumentacionit pas protokollimit të kërkesës për heqje dorë, kërkesa është kaluar te drejtuesi i prokurorisë, i cili ka disponuar me vendimin mbi “*Pranimin e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit*”, vendim i cili regjistrohet në librin e protokollit të komunikimeve të brendshme, duke proceduar me njohjen e palëve me këtë vendim (prokurorëve) deri në hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit. Kjo procedurë është ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër, ndërsa procedura nuk është ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë.
- Në të gjitha praktikat për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Shkodër është hedhur short manual.
Dokumentacioni i dërguar nga zyrat e prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë objekt i këtij inspektimi, nuk është shoqëruar me procesverbalet për hedhjen e shortit përkatës, për të konkluduar lidhur me evidentimin e të gjitha fakteve të ndodhura gjatë procedurës së pranimin të kërkesës/deklarimit të heqjes dorë dhe vendimin e drejtuesit mbi zëvendësimin e prokurorit.

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë evidentohet fakti se është e pamundur të identifikohet praktika e plotë e regjistrimit në protokollin e prokurorisë të deklaramit të prokurorit për heqje dorë nga procedimi penal, momentit të kalimit të drejtuesi i prokurorisë, vendimin e arsyetuar nga drejtuesi i prokurorisë për pranimin ose jo të deklaramit të heqjes dorë të prokurorit, dorëzimi tek sekretaria, njoftimin e palëve dhe hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit, për faktin se një kopje e kësaj praktike nuk regjistrohet dhe nuk mbahet në arkivë, por kërkesa dhe vendimi i drejtuesit administrohet në fashikujt e procedimeve penale përkatëse.

Nga inspektorët përgjegjës u vu re mungesa e plotë e informacionit në drejtim të rasteve kur zëvendësimi është bërë për shkaqe të tjera, veç shkakut kur prokurori është shkarkuar me vendim të KPK-së ose KPA-së.

- Nga inspektimi i kryer rezultoi se për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë referuar dokumentacionit vendimi i arsyetuar nga drejtuesi i prokurorisë për pranimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit është i paprotokolluar. Në këtë prokurori nuk identifikohet praktika e plotë e momentit të kalimit të kërkesës së prokurorit për heqje dorë nga procedimi penal, regjistrimi i saj në protokollin e prokurorisë, dhe dorëzimi tek sekretaria, njoftimin e palëve dhe hedhjen e shortit të zëvendësimit të prokurorit, për faktin se një kopje e kësaj praktike nuk regjistrohet dhe nuk mbahet në arkivë, por mbahet në fashikujt e procedimeve penale përkatëse.
- Në ndjekjen e këtyre praktikave, referuar vendimeve të Drejtuesve të Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë rezulton se drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës “Për heqjen dorë” të paraqitur nga prokurori edhe për shkak “të ngarkesës në punë”. Në këto vendime evidentohet fakti se drejtuesi i prokurorisë i është referuar nenit 17, pika “ë” të K. Pr. Penale, i cili citon: *Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”*. Në këto vendime të konstatuara kërkesa e prokurorit lidhet me ngarkesën në punë, shkak i cili është i paargumentuar nga drejtuesi i prokurorisë në lidhje me faktin se nuk pasqyrohet ngarkesa në punë e prokurorit në krahasim me prokurorët e tjerë të seksionit përkatës. Në këto raste, drejtuesi i prokurorisë duhej të vlerësonte ngarkesën e prokurorëve dhe duhej të organizonte rishpërndarjen e çështjeve në short⁴³.
- Nga Drejtuesit e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Vlorë dhe Shkodër nuk është evidentuar asnjë rast që të jetë vendosur nga drejtuesi zëvendësimi i prokurorit, në bazë të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴³ Udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

- Duke pasur parasysh ngarkesën në punë që shoqëron sot magjistratët prokurorë, praktika dhe rastet e zëvendësimit të prokurorëve zënë një vend të vogël nga 0.1% deri 0.2 % të çështjeve hetimore që zëvendësohen.

V. Rekomandimet

Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë **subjekte të inpektimit:**

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me praktikën më të mira të identifikuar dhe problematikat e konstatuara në respektimin e rasteve dhe kushteve të parashikuara në ligjin procedural penal lidhur me trajtimin e deklarimeve për heqjen dorë nga ushtrimi i funksionit të prokurorit në hetimet e procedimit penal, si dhe vendimet e marra nga drejtuesit e prokurorive për pranimin e deklaramit për heqjen dorë dhe për zëvendësimin e prokurorit.
- Rekomandohet për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë, të ndiqet e njëjta praktikë që deklaramet për heqjen dorë të prokurorit ose kërkesat për heqje dorë/zëvendësim të drejtuar nga palët e procedimit penal, si dhe vendimet e drejtuesit të prokurorisë të pasqyrohen rregullisht të regjistruara në librat e sekretarisë dhe regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, sipas Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*".
- Rekomandohet për të gjitha prokuroritë subjekte të inspektimit mbajtja më vete në zyrën e sekretari-arkivë e një kopje të praktikave të heqjes dorë dhe zëvendësimit të prokurorit (deklaramit për heqje dorë të prokurorit ose kërkesës së subjekteve të procedimit për heqje dorë/zëvendësimin e prokurorit dhe informacionit të prokurorit në lidhje me këtë kërkesë, vendimin e drejtuesit të prokurorisë, si dhe të dokumentimit të procedurës së përzgjedhjes me short të prokurorit që do t'i caktohet çështja) në mbështetje të neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo edhe në funksion të ushtrimit të funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektimet vijuese tematike mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve në zbatim të nenit 49, pika 6 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar.

Për Prokurorin e Përgjithshëm

- Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm, si autoriteti që ka përgjegjësi për punën e prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, pjesë e të cilave ishin subjektet e këtij inspektimi.

Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë

- Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për t'u pasur në konsideratë veprimtaria e drejtuesve të prokurorisë, gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 në drejtim të respektimit të ligjit procedural gjatë trajtimit të deklarimeve me objekt heqjen dorë nga prokurorët, si dhe vendimmarrjen e drejtuesit të prokurorisë në lidhje me këto deklarata.

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

- Ndjekja në vazhdimësi në inspektimet vijuese të problematikës së evidentuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vlorë në drejtim të:
 - mosidentifikimit të praktikave të rasteve të zëvendësimit të prokurorit;
 - mospasqyrimit të kërkesave/deklarimit të paraqitur nga prokurori për heqje dorë, të vendimit të drejtuesit që ka pranuar ose jo kërkesën për heqjen dorë të prokurorit dhe protokollimin e tyre;
 - mosidentifikimin e procedurës së rishortimit të çështjes në rastet kur kërkesa/deklarimi për heqje dorë është pranuar dhe drejtuesi ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit tjetër, me anë të shortit elektronik.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar,

PROPOZJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 6/5, datë 30.06.2023, "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 31.12.2022"", të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Caktimin e periudhës nga data 02.05.2024 deri në datën 02.09.2024, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

3. Të njoftohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.

4. Njoftimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, me Raportin e Inspektimit, duke iu dërguar një kopje të këtij raporti.

INSPEKTORËT

Alma Tafani



Lindita Ziguri



Julian Zonja

